



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2021:052697

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05491348

CN.nr.32/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje prej gjyqtarës së vetme gjykuese Elvira Emimi, në çështjen kontestimore të propozuesit E. G. nga fsh. T. K. Lipjan, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit S. G., dhe tani me autorizim bartës e përfaqësojnë Ekrem Agushi av. nga Prishtina dhe asistenti i tij Kushtrim Agushi jurist nga Prishtina, kundër kundërpropozuesit Republika e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor-Departamenti i Shpronësimit, me objekt të çështjes ndryshimi i shpërblimit në paluajtshmërinë e shpronësuar dhe shpërblimi për humbjen e vlerës së paluajtshmërisë së pashpronësuar, jashtë seance me dt. 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Procedura** në këtë çështje juridike jokontestimore **NDËRPRITET**, për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake.
- II.** Në të gjitha rastet gjykimi i ndërprerë do të vazhdojë me propozimin e palëve, pasi të kenë pushuar shkaqet e ndërprerjes.

A r s y e t i m

Propozuesi, përmes të autorizuarit, pranë kësaj gjykate me dt. 22.03.2021 ka parashtruar propozimin, kundër kundër kundërpropozuesit, me objekt të çështjes ndryshimi i shpërblimit në paluajtshmërinë e shpronësuar dhe shpërblimi për humbjen e vlerës së paluajtshmërisë së pashpronësuar.

Ndërkohë që në procedurën e nxjerrjes së provës me ekspertizë gjeodezike, nga ekspertja e gjeodezisë gjykata është njoftuar se e njëjta nuk ka arritur që ekspertizës gjeodezike t'ia bashkangjesë çertifikatën e pronës për ngastrën lëndore *numri...* në pamundësi të sigurimit nga zyra kadastrale në Lipjan, për shkak se ne procedurën e kërkesës së saj për pajisjen me Certificate të Pronësisë për ngastrën kadastrale *numri...* ZK S., Komuna e Lipjanit, respektivisht Udhëheqesja e Sektorit të Kadastrit në Lipjan i është përgjigjur të njëjtës se: "Në lidhje me ngastrën kadastrale *numri...* është pronë e E.G. për të cilin Prokurorja shtetërore J. P. ka bërë kërkesë KT.I.nr.191/18, në zyrën kadastrale komunale në Lipjan, përmes së cilës në kërkesën e saj me nr. *numri...* ka kërkuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Lipjan që, pasi që i dyshuari E. G. është në arrati dhe për të është lëshuar Urdherarrest Ndërkombëtar, të mos veproni në lidhje me kërkesat e paraqitura nga personat e tjerë në emër të dyshuarit, dhe nëse një person paraqitet të paraqesë një kërkesë në emër të dyshuarit, menjëherë ta informoni Policinë e Kosovës.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të këtij fakti, nga Prokuroria Themelore në Prishtinë departamenti për Krime të Rënda ka kërkuar informacione rreth procedurës penale ndaj propozuesit.

Ndërkohë që me datën 20.03.2024 Prokurorja e shtetit J. P., gjykatën e ka njoftuar se ndaj të dyshuarit E. G. (këtu propozuesit) është lëshuar Urdhërarresti Ndërkombëtar për veprën penale të vrasjes së rëndë, dhe urdhri për sekuestrim të përkohshëm të pasurisë së të njëjtit, në mesin e të cilave është edhe ngastra kadastrale *numri...* ZK S., dhe në proces është edhe dhënia e urdhrin përfundimtar të sekuestrimit, për të cilin kërkesa i është dërguar gjykatës. Si provë gjykatës ia ka bashkangjitur Urdhrin e përkohshëm të ndalimit të disponimit me pronë dhe bartjes së pronësisë mbi pronat, në mesin e të cilave është edhe prona lëndore.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 13 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ngase gjeti se procedura penale paraqitet të jetë çështje paraprake pa përfundimin e së cilës gjykata nuk mund të vazhdojë me këtë procedurë.

Bazuar në këto fakte, dhe meqenëse çështja në fjalë paraqet çështje paraprake, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform dispozitave të nenit 278.1 dhe pika (a), nenit 278.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN.
Departamenti i Përgjithshëm

CN.nr.32/21 dt. 20.03.2024

G j y q t a r j a
Elvira Emini

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.